



KONFERENCA  
***Diaspora Flet***

PROMOVIMI I  
SHKËMBIMIT PROFESIONAL  
ME DIASPORËN SHQIPTARE

## PROMOVIMI I SHKËMBIMIT PROFESIONAL ME DIASPORËN SHQIPTARE

**17-20 MAJ 2018**

### **Nxitja e shkëmbimit profesional**

#### **VIZIONI**

Vizioni ynë është të nxisim kontributin pozitiv të diasporës shqiptare në zhvillimin politik, shoqëror dhe ekonomik të vendeve amë.

#### **OBJEKTIVAT**

1. Rikthimi i besimit dhe lidhjes në mes të Diasporës shqiptare dhe vendit të tyre amë, si dhe promovimin e vlerave kulturore dhe historike përmes programeve frymëzuese dhe programeve të veprimit/aktivizmit;
2. Krijimi i rrugëve pozitive dhe jo-diskriminuese për angazhimin profesional të diasporës në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit amë; dhe
3. Promovimi i praktikave më të mira duke marrë qasjen "mendoni global, veproni lokal" për të influencuar në hartimin e politikave dhe duke siguruar që ato përfaqësojnë përfshirjen dhe krijimin e mbajtjes së vlerave të përbashkëta në vendet amë.

#### **HISTORIKU:**

Qeveritë tona kanë dëshmuar se janë më pak se partner të besueshëm gjatë viteve për angazhimin e diasporës shqiptare në një mënyrë të koordinuar dhe institucionale. Përkundër hapit pozitiv në krijimin e Ministrisë së Diasporës, është e rëndësishme që anëtarët e Diasporës shqiptare të angazhohen pozitivisht dhe të marrin një rol proaktiv. Grupi ynë i punës përbëhet nga **20 profesionistë anëtarë të diasporës, që përfaqësojnë tetë (8) rajone nga bota**, të cilët kanë ekspertizë, rrjete dhe përvoja shumë të pasura dhe të ndryshme.

#### **METODOLOGJIA**

Grupi punues kanë punuar së bashku nga periudha kohore shtator 2017- mars 2018, duke dhënë kontributin e tyre profesional në ndërtimin e këtij planit të veprimit.

Puna grupore është ndarë në dy pjesë:

**Faza e parë:** Gjatë fazës hyrëse, u arrit pajtimit me objektivat e grupit. Disa ide u shkëmbyen gjatë takimit të parë virtual dhe disa anëtarë u angazhuan përmes e-mailit. Është zhvilluar një pyetësor dhe ka kaluar në fazën e konsultimit.

**Faza e dytë:** Gjatë kësaj kohe, është zhvilluar takimi i dytë virtual, planifikimi i planit të veprimit dhe shkëmbimi i ideve si dhe sugjerimeve shtesë në formësimin/kompletimin e planit të veprimit. Në këtë fazë, është ndarë edhe pyetësori me anëtarët e grupit dhe rrjetet e tyre.

**Faza e tretë:** Plani i Veprimit u hartua në konsultim me të gjithë anëtarët e grupit; dhe u përfundua më 15 Prill 2018, si dhe u bën përgatitjet për ta prezantuar në Konferencën e Diasporës 10-13 maj 2018.

SI?

1. Kontribut në përpunimin e databazës së profesionistëve shqiptarë jashtë vendit;
2. Incentivat financiare (**Fondi i Shkëmbimit Profesional**) për të nxitur përfshirjen e profesionistëve shqiptarë në formimin dhe zhvillimin politik, shoqëror dhe ekonomik të vendit amë; dhe
3. Programi i përshtatshëm për shkëmbime profesionale –

## **PLANI I VEPRIMIT**

### **Faza 1:**

'Shkëmbim profesional virtual' - propozim i planit të veprimit me vizion afatshkurtër, për të filluar me 12 prezantime online "webinar" gjatë një periudhe 24 mujore, e cila do të përfshijë sfidat më të ngutshme dhe çështjet me të cilat ballafaqohen qytetarët e vendeve amë. Pesë (5) temat e propozuara janë:

*Shëndetësia:* për shembull: Përmirësimi i shëndetit: Në prag të mbipeshës vrasëse! - çështja e obezitetit tek fëmijët dhe të rriturit është një çështje e ngutshme. Pse po ndodh, si t'i qasemi dhe cilat janë praktikatat më të mira nga të cilat mund të mësojmë?

*Arsimi:* A është sistemi arsimor duke vlarë krijimtarinë/talentin e fëmijëve tanë? - diskutimi i problemeve të lidhura nga konteksti global dhe respektimi i kontekstit lokal. Të njëjtat pyetje, pse, si dhe çfarë mësojmë?

*Pabarazitë:* Rritja e pabarazive inkurajon lakminë dhe shkatërrimin. Tema do të analizojë pabarazitë në të gjitha aspektet, megjithatë më e ngutshme do të ishte pabarazia gjinore dhe e të ardhurave. Kjo temë mund të demonstrohet duke pyetur si: Ku na drejton lakmia? Ose 'femër vs grua' duke trajtuar çështjet e identitetit femëror në Kosovë për shembull.

*Mjedisi:* Lakmia dhe pushteti çojnë në shkatërrime dhe në një numër sfidash shoqërore. Përfshirja e sfidave të lidhura me ndryshimet klimatike. Tema është pothuajse e panjohur në rajonet tona dhe kërkon veprim. Temat të tilla si 'Ndryshimi i klimës: Çfarë Klime?' Cilat janë zgjidhjet, si bëhemi agjentë të ndryshimit?

*Qeverisja:* Përmes veprimit "Liderët frymëzues" ne do të hapim mendjet e pjesëmarrësve/liderëve të rinj, duke eksploruar udhëheqjen transformuese (shtetërore, private dhe civile). Si t'i frymëzojmë dhe krijojmë liderët e rinj? Cili është roli i diasporës në këtë?

*Arti dhe Kultura:* Si mundemi ne të fuqizojmë ndryshimin përmes artit dhe kulturës? Cilat janë temat të cilat nuk i diskutojmë? A mund të zbulojmë se kush jemi me të vërtetë? A mund ta pranojmë atë që jemi? Si mund ta lidhim të kaluarën me të tashmen dhe të lëvizim në të ardhmen tonë?

*Përmirësimi i efikasitetit të biznesit:* Identifikimi i nevojave specifike nga bizneset vendore: operacionet, menaxhimi, shitjet, zinxhiri i furnizimit, programi i shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve. Përdorimi i modele të ndryshme praktike në përditshmëri krijimi i databzës për operim dhe udhëzime efektive për menaxhim, modalitetet e të cilave do të jenë temë diskutimi në seancën e Konferencës, të ngjashme me versionin më poshtë.

## **PLANI I VEPRIMIT II:**

Akademia Star / Shkolla e Diasporës - propozimi për vizionin afatgjatë i cili do të fillojë duke mbledhur prova nga faza 1, dhe me kontribuuesit potencial nga vendet amë. Kurikula e zgjedhur do të përdoret për t'i ftuar të tjerët përmes bashkëbisedimit virtual (p.sh LinkedIn). Kjo shkollë do të përdorë inovacionin si misionin e saj kyç dhe kurikula do të përfshirje moduke në të gjitha temat e specifikuar më sipër: Arsimi, Pabarazitë, Qeverisja, Mjedisi, Arti & Kultura.

Indira Kartallozi, Belgjikë – Kryesuese e grupit

Pandi Zdruli, Itali

Bahir Troja, Austri

Shqipe Buzuku, Finlandë  
Indrit Vuçaj, ShBA  
Bensar Qollaku, ShBA  
Ilir Ademi, ShBA  
Fatmir Memaj, Shqipëri  
Ardian Xhemalli, Greqi  
Miranda Ademaj, Zvicër  
Ahmet Gjanaj, Belgjikë  
Besmir Buranaj Hoxha, ShBA  
Islam Aliaj, Zvicër  
Nezir Krasniqi, Kanada  
Konstandin Ristani, Kanada  
Deshira Shehu, Austri  
Zyrafete Loshaj, Suedi  
Valdete Hoti, Zvicër  
Nejla Ayvazi, Azerbajxhan

DRAFT